



Në bazë të Ligjit Nr. 08/L – 197 për zyrtarët publikë, Neni 39 (1,2,3,4,5 dhe 6) dhe Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 5 Ministria e Drejtësisë - Shërbimi Sprovues i Kosovës shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Grupi i administrimit të përgjithshëm
Titulli i pozitës së punës	Zyrtar për Arkiv 3
Klasa e pozitës	Profesional 3
Koeficienti/Paga	4
Nr. i kërkuar	1
Kohëzgjatja e emërimit	Emërim me afat të pacaktuar
Data e njoftimit	13/03/2024
Afati për aplikim	14/03/2024 - 12/04/2024
Institucioni	Ministria e Drejtësisë - Shërbimi Sprovues i Kosovës
Departamenti	Drejtorite Regjionale
Divizioni	Drejtoria Regjionale në Prizren
Vendi i punës	Prizren
Nr. i Referencës	RN00013556
Kodi	RPC0007095



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

Pranon dokumente dhe lëndët për arkivim dhe kujdeset për arkivimin e tyre në përputhje me procedurat ligjore;

Kujdeset për sistemin dhe mbajtjen azhure të lëndëve

arkivore, si dhe propozon udhëzues të nevojshëm për funksionimin e arkivit;

Mirëmban arkivin e veçantë për raste të detajuara specifike dhe

e ruan paprekshmërinë e informatave

Përkujdeset për seleksionimin e rregullt të lëndës arkivore;

Mban kontakte të vazhdueshme me institucionet e arkivit të

Kosovës, me qëllim të dorëzimit të lëndëve arkivore, arkivit kompetent pas

kalimit të afatit;

Ndërmerr veprime tjera të nevojshme për funksionimin sa më të

mirë të ligjit, mbi lëndët arkivore të Kosovës;

Koordinon punën me nënpunësit që merren me postën për

shpërndarjen e postës, shkresave jashtë dhe brenda institucionit;

Kryen edhe punë tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të

cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

Zyrtari i arkivit i përgjigjet Udhëheqësit të Drejtorisë

rajonale në Prizren



2.Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- **Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e shkollës së mesme .**
- **Kërkesat specifike:** Nuk kërkohen
- **Përvoja e punës e kërkuar:** Nuk kërkohet

4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- Njohuri bazike sipas fushës së arsimit përkatës;
- Shkathtësi në caktim të objektivave , planifikim të punës dhe analizë;
- Shkathtësi në komunikim me stafin me të njëjtin nivel brenda institucionit;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internet);
- Njohja e gjuhës shqipe apo serbe;



5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës.
- Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më të vjetër se (6) muaj nga data e lëshimit.
- Kopjet e dokumenteve tjera që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet më së largu deri më datën 27/04/2024, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Kriteret specifike shtesë

//

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 30 pikë

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

10. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.



Të dhëna shtesë:

//

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

